

asi

ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

Mars 2005, Nr. 16



Porosia nga
Parlamenti European

ORA kritikon projektligjin për
bugjetin e Kosovës për vitin 2005

Naim Jerliu:
Sfida e implementimit të ligjeve



Ju falënderojmë ambasador Fieski!

Që nga janari i vitit 2002 deri më mars 2005 ambasador Paskal Fieski ka kryesuar Misionin e SOBE-së në Kosovë. Ai njëkohësisht shërbeu edhe si zëvendës i Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara, përgjegjës në shtyllën për ngritjen e kapaciteteve të UNIMIK-ut. Gjatë mandatit të tij si kryesues i Misionit ambasador Fieski punoi në krijimin e Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes dhe ka mbikëqyrur Zgjedhjet qendrore dhe komunale në 2002 dhe 2004. OSBE-ja dëshiron të shpreh mirënjohjet e veta për përkushtimin dhe profesionizmin e ambasador Fieskit gjatë tri viteve të kaluara dhe i dëshiron fat në vitet që pasojnë!

Lajme të shkurtëra

Shfaqje kulturore e romëve dhe ashkalinjëve në Kuvendin e Kosovës

Kuvendi i Kosovës ishte nikoqir i shfaqjes së kulturës rome dhe të ashkalinjëve, nga 24 deri më 27 janar të vitit 2005. Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe Qendra për dokumentim e romëve dhe ashkalinjëve (QDRA) e organizuan këtë ngjarje, të përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Ekspozimi i vizatimeve, fotografive dhe poezive nga ana e artistëve të rinj romë dhe ashkalinjë kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për gjallërinë dhe fuqinë e bashkësive të romëve dhe ashkalinjëve të Kosovës përmes shembujve nga trashëgimia e tyre kulturore në institucionin e Kosovës me profil më të lartë, Kuvendin e Kosovës. Në pranimin që u mbajt me rastin e hapjes më 24 janar të pranishmëve iu drejtuan Prof. Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, Ambasadori Pascal Fieschi, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë, dhe bashkëdrejtuesit e Qendrës për dokumentim të romëve dhe ashkalinjëve, Z. Bekim Syla dhe Z. Adem Osmani. Në këtë pranim morrën pjesë liderët e komuniteteve dhe ata politik nga bashkësitë e romëve dhe ashkalinjëve, anëtarët e Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit nga IPVQ-të, UNMIK-u, Zyrat ndërlidhëse të shteteve të jashtme, dhe të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare që janë të angazhuara në punën me këto komunitete. Për më tepër informata, kontaktoni Mario.maglov@osce.org

Përgjegjësia e Parlamentit drejt përbushjes së standardeve

Më 10 shkurt 2005 Qendra informative për qeverisje parlamentare (Parliamentary Governance Information Center-PGIC) ka qenë nikoqire e diskutimit publik me temën "Përgjegjësia e Parlamentit drejt përbushjes së standardeve". Në këtë ngjarje kanë qenë të pranishëm dy anëtarë të Kuvendit të Kosovës, Znj. Sanije Alija dhe Z. Mahir Yağcılar, si dhe Koordinatorin e qeverisë për standardet, Z. Avni Arifi. Qendra informative për qeverisje parlamentare është themeluar në prill të vitit 2004 përmes UNDP-Kosovës dhe projektit SPEAK të Unionit ndërparlamentar, në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Kosovës dhe Bibliotekën kombëtare dhe universitare të Kosovës. Qendra informative e vendosur në Bibliotekën kombëtare dhe universitare ka për qëllim t'ia ofrojë publikut lidhjen e internetit për sistemin e arkivit dhe webfaqen e Kuvendit të Kosovës.

Parlamentarët nga tri shtete evropiane diskutojnë për rolin e opozitës dhe koalicionit qeveritar

Më 18 shkurt 2005 projekti i finansuar nga Agjencioni evropian për rindërtim (AER) në përkrahje të Kuvendit organizoi forumin-diskutimin e dytë, për rolin e parlamentarëve nga shumica dhe opozita. Gjashtë deputetë nga Franca, Gjermania dhe Belgjika i kanë shkëmbyer përvojat e tyre dhe janë inkuadruar në debatin energjik me anëtarët e Kuvendit të Kosovës. Debatet më të detajizuara janë zhvilluar në tryezat e rrumbullakëta të veçanta lidhur me temat në vijim: marrëveshjet në mes të koalicionit qeverisës dhe opozitës, menaxhimi i parlamentit nga ana e Kryesisë dhe kontrolli i buxhetit, marrëdhëniet ndërparlamentare, procesi i ligjberjes, pyetësorët parlamentarë dhe kontrolli i zbatimit të legjislationit. Deri në mesin e marsit të vitit 2005, Konzorciumi i tri parlamenteve nga Franca, Belgjika dhe Gjermania është duke e përfunduar projektin 18 mujor i cili i ishte besuar nga AER-i.

Dëgjimet e rregullta publike që janë mbajtur për shqyrtimin e projektligjeve

Tanimë të ballafaquar me një numër të madh të projektligjeve të dorëzuara nga qeveria, komisionet e Kuvendit kanë vazhduar me seancat e tyre të rregullta. Çdo javë Kuvendi po organizon dëgjime publike për ato projektligje që konsiderohen si më thelbësore për ta siguruar përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile dhe publikut të përgjithshëm. Në fillim të shkurtit u mbajtën dëgjime publike për projektligjin mbi Komisionin e pavarur të mediave, projektligjin mbi sigurimin shëndetësor, dhe projektligjin mbi OJQ-të. ASI e përshëndet faktin se dëgjime të reja publike po bëhen në javët vijuese pasi që projektligjet po miratohen në leximin e parë. Gjithashtu në fillim të shkurtit, Instituti demokratik kombëtar (NDI) ka organizuar një seminar ku kishte pjesëmarrje të gjerë me kryetarët e komisioneve lidhur me rëndësinë dhe funksionimin e dëgjimeve publike. Doracak i dëgjimeve publike, i publikuar nga mesi i vitit 2004, i është rishpërndarë të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në adresimin e tij në seancën plenare më 3 dhjetor 2004, PSSP-ja Søren Jessen-Peterson inkurajoi Kuvendin që të mbajë dëgjime publike si një instrument për inkuadrimitin e përvojave shtesë dhe për rritjen e pronësisë së shoqërisë civile në ligjet e propozuara

Porosia nga Parlamenti European

Josep BORRELL FONTELLES
Kryetar i Parlamentit European

BE-ja çdo here e më shumë po bëhet pike referuese për zhvillimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit bazuar në sistemin politik. Në majin e vitit të kaluar, 8 vende të Europës Qëndrore dhe Lindore iu bashkuan BE-së, së bashku me Maltën dhe Qipron, që paraqesin zgjerimin më të madh të BE-së deri tani. Ishte ky një sukses i madh dhe dëshmi e qartë e fuqisë tërheqëse që kanë proceset e integritimeve europiane.

Më lejoni të ju përkujtoj që Parlamenti European ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe aktiv në zgjerimin e fundit, i cili dominohej nga puna e Parlamentit tonë gjatë mandatit të fundit legjislativ. Ne nuk do të duhej të harrojmë rolin e Parlamentit derisa po punojmë bashkarisht që të sjellim Ballkanin Perëndimor në rrugë të drejtë për në integrimin europian.

Parlamenti ynë vazhdimisht ka zënë pozicionin e vet përmes Procesit të Stabilizim Asociimit, BE-ja me sukses mund të përsëris qasjen e miratuar ndaj vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore, duke u nisur nga fakti që këto vende me sukses përmbushën kushtet për anëtarim në BE: Por kjo nuk mund të arrihet pa procesin e pajtimit që paraqet një vizion të përbashkët për të ardhmën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Jam sinqerisht i bindur që pavarisisht çfarë do të jetë vendimi për Kosovën në muajt e ardhshëm, e ardhmja e Kosovës qëndron në Europë. Dhe mu ky parim duhet të përcaktojë planet për reformat dhe zhvillimet politike, ekonomike

dhe sociale gjatë periudhës së ardhshme.

Duke u nisur nga ky fakt, Parlamenti European qartë avokon një rol më aktiv të BE-së në Kosovë. Kjo është riafirmuar edhe gjatë Dëgjimit të paradokohshëm public të Komisionit për Punë të Jashtme mbi situatën në Kosovë, të mbajtur më 25 janar në Bruksel. Gjatë dëgjimit morrën pjesë ekspertë të pavarur si dhe përfaqësues nga Kosova, Qeveria e Serbisë dhe Malit të Zi, si dhe UNMIK-u.

Sfida kryesore për Kosovën ishte krijimi i institucioneve demokratike dhe krijimi i një shoqërie multietnike në të cilën sundon ligji. UNMIK-u dhe IPVQ kanë ndërmarrë shumë hapa në këtë drejtim duke krijuar ligjet e domosdoshme për një juridiksion të mirëfilltë.

Roli i Kuvendit të Kosovës është tejet qenësor në këtë proces, si parlamentarë ju jeni, përfaqësues të zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit të Kosovës. Dhe ngelet përgjegjësia juaj që në Kosovë të mbretërojë stabilizimi, demokratizimi dhe modernizimi. Ju keni përgjegjësinë që të punoni për mirëqenien e popullit të Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, politike apo sociale.

Zhvillimet e vitit të kaluar kanë treguar që rregullat e punës nuk gjenerojnë progresin vetvetiu, po që se nuk janë të zbatuara drejt, apo nëse ka mungesë të vullnetit politik për të bërë një gjë të tillë. Dhe bashkësia ndërkombtare nuk mund të zëvendësojë një vullnet vendor politik - BE-ja dhe akterët tjerë



ndërkombtarë munden vetëm të ndihmojnë dhe t'i mbështesin proceset në fjalë.

Dhuna tragjike e Marsit të kaluar dëshmoi që, Kosova multietnike ku të gjitha grupet etnike dhe fetare do të jetojnë të lirshëm dhe pa frikë nuk ka alternative tjetër. Unë, fuqishëm apeloj tek forcat politike shqiptare që të përkushtohen dhe të gjejnë mënyrat për bashkëpunim dhe dialogim me komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshqiptare. Njëkohësisht, besoj që mënyra më e mire për të mbrojtur të drejtat e minoriteteve në Kosovë është pjesëmarrja e tyre aktive në institucionet e Kos-

ovës, përfshirë këtu edhe Kuvendin e Kosovës. Aq më tepër që një rekomandim i tillë doli edhe nga takimi i përbashkët i Delegacionit të Parlamentit për Europën Juglindore dhe Parlamentit të Serbisë dhe Malit të Zi në dhjetorin e vitit të kaluar.

Kështu që, le të punojmë së bashku për të arritur progresin në pikat kyçe të përcaktuara nga Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovën nga ana e UNMIK-ut dhe IPVQ të Kosovës. Kuvendi juaj ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në këtë proces, dhe ju mund të llogarisni në mbështetjen e Parlamentit European.

Sfida e implementimit të ligjeve

Legjislatura kryen një numër të funksioneve të rëndësishme në demokraci: i përfaqëson qytetarët – duke adresuar nevojat, aspiratat, problemet, shqetësimet dhe prioritetet e tyre në procesin e bërjes së politikave të reja apo amendamentimit të politikave ekzistuese; i nxjerrë ligjet – rregullat me të cilat qeveriset vendi; si dhe ushtron mbikqyrjen e ekzekutivit duke siguruar që ligjet e miratuara zbatohen me korrektësi dhe efektivitet.

Naim Jerliu, Deputet në Kuvendin e Kosovës (LDK)

Implementimi i ligjit është një sfidë e re e cila lind pas kalimit të ligjit nëpër Kuvend dhe miratimit të tij. Edhe për ligjvënës-deputetët, por edhe për të tjerët është e ditur se puna parlamentare nuk mbaron kur aprovohen ligjet. Ligjet aprovohen që të funksionojnë, të vihen në jetë dhe të administrohen në një mënyrë efektive, efikase dhe ekonomike.

Implementimi i ligjit dhe mekanizmat implementues

Aktiviteti ligjvënës në Kosovë gjatë viteve të kaluara ka sjellë si rezultat ligje të miratuara në Kuvendin e Kosovës, të cilat rregullojnë aspekte të gjëra të marrëdhënieve shoqërore. Duke qenë në përputhje me standarde aktuale ndërkombëtare, ky legjislacion me qëllim të implementimit të suksesshëm, ka paraparë instrumente implementuese. Mjete më të përdorura implementuese janë krijimi i agjencioneve të posaçme që bëjnë implementimin e ligjit, krijimi i bordeve ose këshillave mbikqyrëse për implementimin e ligjit, si dhe nxjerrja e akteve nënligjore në formë të udhëzimeve administrative, direktiveve administrative ose statuteve.

Me gjithë këtë kualitet në përmbajtje, në Kosovë jemi dëshmitarë të një situatë ku nuk kemi vërejtje në implementimin e këtij legjislacioni. Lidhur me këtë çështje OSBE-ja ka publikuar në fillim të këtij viti një Raport mbi zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës duke shqyrtuar ligjet e shpalluara gjatë viteve 2002-2003. Raporti shqyrton zbatueshmërinë e ligjeve të Kuvendit të Kosovës

nga ana e Qeverisë dhe shkallën deri në të cilën janë zbatuar këto ligje në mënyrë të duhur përmes miratimit të legjislacionit subsidiar (akteve tjera nënligjore). Sipas këtij Raporti, proceset e hartimit dhe miratimit të dekreteve shtesë kanë filluar me vonesë, por sidoqoftë është arritur sukses i konsiderueshëm. Krahas kësaj, Raporti zbulon të meta të rëndësishme brenda rregullativës ekzistuese të akteve nënligjore. Raporti, gjithashtu thekson se zbatim i kuadrit të ri ligjor të Kosovës nuk e kishte vëmendjen e plotë të administratës ndërkombëtare, ndërsa institucionet kosovare nuk e përqendruan vëmendjen e tyre në këtë çështje për shkak të prioriteteve tjera ekzistuese. Sigurisht, nevoja për hartimin e ligjeve të reja është vënë në plan të parë me qëllim të tejkalimit të hendekut në mes të sistemit juridik të trashëguar dhe realitetit të ri social, ekonomik dhe politik. Ndërsa, kjo ka bërë që të ketë përqendrim më të madh në hartimin e ligjeve të reja, se sa në zbatimin e atyre që kanë hyrë në fuqi.

Në kontekst të këtillë, vëmendja e legjislaturës të tanishme të re sigurisht që kërkon fokusim dhe përqendrim të veçantë në planin e implementimit të ligjeve të miratuara. Në pikëpamje ideale, deputetët dhe në mënyrë specifike çdo komision, do të duhej rregullisht të monitorojnë aplikimin e ligjeve dhe implementimin e programeve brenda jurisdiksionit përkatës të tij. Komisionet do të duhej të marrin një rol aktiv dhe veprues në vlerësimin administrativ të aplikueshmërisë dhe zbatimit të ligjeve të miratuara në Parlament.



Autoriteti për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit

Rregullorja ekzistuese e Përkohshme e Punës së Kuvendit i përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat që kanë të bëjnë me mbikqyrjen e zbatimit të Ligjeve përmes rregullës 10 mbi të drejtat dhe detyrat e deputetit, ndërsa në mënyrë më specifike i adreson nëpërmes Rregullës 44 mbi autoritetin e komisioneve në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Rregulla përcakton se secili komision në kuadër të fushës së veprimtarisë së vet ka autoritet për të mbikqyrë zbatimin e ligjit nga ministria përkatëse apo nga Qeveria e Kosovës. Për të realizuar këtë autoritet, komisionet kryejnë kontrolle dhe studime të efektiviteteve të ligjeve në fuqi mbi çështjet nga autoriteti i

vet, si zbatohen ato dhe bëjnë propozimin e masave në raste konkrete; ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e ministrisë përkatëse dhe të institucioneve që varen dhe drejtohen nga ministria, si dhe mund të detyrojnë një ministër ose një person të autorizuar nga ai, që të marrë pjesë dhe të dëshmojë në një mbledhje para komisionit. Në Projektpropozimin e ri të Rregullores së Punës (të miratuar nga Komisioni për Hartimin e Rregullores së Punës), që pritet të aprovohet shpejt nga Parlamenti, krahas autoritetit të theksuar më sipër që është në fuqi, parashihet që Ministria përkatëse t'i raportojë komisionit funksional në lidhje me implementimin e ligjit pa kërkesë, së paku një herë në vit. Gjithashtu, parashihet që komisionet gjatë ushtrimit të

autoritetit të tyre do të përgatisin një listë që përmban ndër të tjera datën e shpalljes së ligjit, datën e publikimit të tij në gazetën zyrtare, listën e dispozitivave të ligjit që duhet të implementohen nga Qeveria, si dhe listën e vendimeve të Qeverisë që implementojnë këto dispozita. Kjo sigurisht që do të lehtësojë hetueshëm dhe do ta bëjë më pragmatike mënyrën në të cilën do të përcjelljet dhe mbikqyret implementimi i ligjeve të miratuara. Gjithashtu, për këtë çështje, Ministrinë do të raportojnë me shkrim dhe gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit. Nëse Ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet i paplotë, me kërkesë të komisionit, çështja do të vihet në rendin e ditës së seancës tjetër plenare. Mendoj se ky është një element i ri i rëndësishëm që duhet të shfrytëzohet maksimalisht në mënyrë që të arrijmë të kemi jo vetëm një pasqyrë të implementimit të ligjeve por edhe të kemi mundësinë të vlerësojmë aplikueshmërinë e tyre në praktikë, sepse përvojat nga shumë vende tregojnë se ekzistojnë raste të shpeshta kur një legjislacion i aprovuar nuk do të ketë mundësinë e aplikueshmërisë, qoftë për faktin se nuk janë paraparë mekanizmat e duhur të aplikimit, qoftë për vlerësimin joadekuat të rrethanave për aplikimin e tij në momentin kur është miratuar.

Normalisht, është e kuptueshme që kjo formë e raportimit që synohet të aplikohet tash do të jetë e rëndësishme, sidomos në këtë fazë të parë në të cilën Kosova ende bëhet me ligjet bazike nga fusha të ndryshme, por me kohën besoj se do të vijmë në situatën kur një raportim i tillë do të jetë jo vetëm i tepërt, por mbase edhe vështirë i realizueshëm. Është e pritshme që vëllimi i legjislacionit subsidiar që ka të bëjë me aplikimin e ligjeve të jetë aq

i madh sa që thjesht do të jetë shumë e komplikuar që për të gjitha këto të raportohet në senacë plenare. Së paku kështu dëshmojnë përvoja të vendeve të tjera.

Një çështje e veçantë shumë specifike që ka të bëjë me implementimin e ligjeve në Kosovë është situata në të cilën ligjet aprovohen nga Parlamenti i Kosovës, mirëpo ato nuk hyjnë në fuqi deri në nënshkrimin dhe shpalljen e tyre nga ana e PSSP-së. Kështu, nga të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi, gjithsej 72 ligje janë nënshkruar deri më tash nga PSSP dhe janë të funksion në Kosovë, përderisa përmbi 20 ligje të tjera presin të nënshkruhen që nga legjislatura e kaluar. Ngadalësia e procesit të nënshkrimit të tyre nga PSSP-ja dhe vënia në funksion e tyre është jashtë mundësive për t'u trajtuar në cilëndo mënyrë nga ligjvënësit, repsektivisht nga Parlamenti i Kosovës dhe kjo përbën poashtu një problematikë në vete shumë specifike.

Në përmbyllje, duke pasur parasysh synimin që legjislacioni i miratuar në Parlament duhet të zbatohet për të jetësuar politikat qeveritare që reflektojnë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, mendoj se është me rëndësi ideja që në funksion të ngritjes së shkallës së llogaridhënies së Qeverisë, mbështetur edhe në përvojat e vendeve të tjera, të konsiderohet formimi brenda Qeverisë i një Agjencioni, respektivisht mekanizmi mbikqyrës të zbatueshmërisë së ligjeve të Kuvendit të Kosovës. Ndërsa Parlamentit i mbetet domosdoshmëria e përqendrimit në mbikqyrjen periodike të shtuar të aktiviteteve të ekzekutivit në implementimin e ligjeve. Në këtë mënyrë do të mund të përballonim më mirë dhe më efektivisht sfidën e madhe të implementimit të ligjeve për çka kanë mandat dhe përgjegjësi të zgjedhurit – përfaqësues të qytetarëve.

Qeveria miraton planin për reformën e qeverisjes lokale

Më 22 shkurt 2005, Qeveria e ka miratuar planin për reformën e qeverisjes lokale të zhvilluar nga Grupi punues teknik për decentralizimin. Regjistri përfundimtar i pesë pilot njësisive/projekteve komunale përfshin Graçanicën në Komunën e Prishtinës dhe Parteshin në komunën e Gjilanit që janë të banuar me serbë të Kosovës; Hanin e Elezit në Komunën e Kaçanikut që gjendet në kufi me IRJ të Maqedonisë; Junikun në Komunën e Deçanit; dhe Mamushën të banuar me popullatë shumicë turke në Komunën e Prizrenit. Ministri i pushtetit lokal, Lutfi Haziri, theksoi se infrastruktura ligjore për fillimin e procesit të decentralizimit ekziston, por do të duhen edhe ligje të reja. Kryeministri Haradinaj kërkoi përkrahjen e partive politike të opozitës pasi që projekti "në asnjë mënyrë nuk shpjen drejt kantonizimit" por përfaqëson "transformim" të strukturave paralele që do të drejtonin kah "shpërbërja" e tyre dhe funksionimi i rregullt i qeverisë lokale, gjë që është "në interes të Kosovës". Ndonëse qeveria nuk i ka kalkuluar plotësisht shpenzimet, ai tha se pritet përkrahja financiare e qeverive të jashtme dhe institucioneve ndërkombëtare.



PDK dhe ORA, megjithatë, e kundërshtojnë planin e decentralizimit. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Jakup Krasniqi, deklaroi se plani i ri nuk bazohet në Dokumentin Kornizë dhe se për këtë arsye ai është jolegal. Ai gjithashtu tha se qëllimi i planit nuk ishte decentralizimi i administratës lokale por "krijimi i enklavave dhe legalizimi i strukturave paralele". ORA e konsideron planin "jolegjitim dhe jolegal për shkak të mungesës së koncenzusit politik sa i përket reformës së qeverisjes lokale". Më 23 shkurt, grupi parlamentar i PDK-së e braktisi seancën plenare të Kuvendit të Kosovës për të protestuar kundër mungesës së debatit për decentralizim në rendin e ditës. Kryesia e Kuvendit të Kosovës më vonë e vendosi që ta thërrasë një seancë të jashtëzakonshme plenare të enjten, më 10 mars, për ta diskutuar decentralizimin.

Intervistë me Dr. Enver Hoxhajn, Kryetar i Komisionit parlamentar për arsim, shkencë, teknologji, rini dhe sport.

Implementimi i legjislacionit mbi arsimin prioritet në agjendën e Kuvendit

Intervistuar nga Christophe Pradier, Zyrtar Politik në Misionin e OSBE-së në Kosovë

Cilat janë aktivitetet e Komisionit për arsim, shkencë, teknologji dhe rini?

Komisioni mblidhet nga dy deri në tri herë në javë. Së fundi ka punuar në projektligjin për trashëgimi kulturore dhe projektligjin për teatrotë. Komisioni është në proces të përgatitjes së planit të aktiviteteve për tri vitet e ardhshme, që duhet të jetë i gatshëm deri nga gjysma e marsit. Unë gjithashtu besoj se Komisioni duhet të bëjë më tepër se vetëm të aprovojë projektligje. Ai ka rolin të ndihmojë Ministrinë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-it) gjatë implementimit të ligjeve përkatëse. Ne kemi planifikuar të vizitojmë MASHT-in dhe Universitetin e Prishtinës për të identifikuar nevojat e tyre. Ne gjithashtu do të ftojme ministrin Agim Veliu që të raportojë para Kuvendit mbi implementimin e ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm dhe ligjin për arsimin e lartë. Komisioni mëton të përkrahë qeverinë në mënyrë që ajo t'i realizojë programet e veta arsimore në aktivitete.

Çfarë është vlerësimi juaj për ligjet që kanë të bëjnë me arsimin?

Ekzistojnë dy ligje themelore: Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe Ligji mbi arsimin e lartë në Kosovë. Megjithatë, reforma e arsimit në Kosovë është e frenuar me zbatimin e kufizuar të këtyre



ligjeve. Problem tjetër është edhe çmimi i lartë që e përcjellë ligjin mbi arsimin e lartë. Për këtë arsye debati aktual në Kuvend lidhur me mundësitë që të ketë buxhet të përgatitur për çdo projektligj është tejet relevant.

Ligjet e aplikueshme nuk i mbulojnë të gjitha çështjet e arsimit.

Ekziston nevoja urgjente për miratimin e ligjeve shtesë siç është ligji për hulumtime shkencore. Arsimi duhet të jetë prioritet parësor i shoqërisë kosovare. Një sistem më i mirë i arsimit do të jepte përfitime siç janë resurset njerëzore më të zhvilluara, kohezioni më i mirë i shoqërisë së Kosovës dhe

rrethana më të avancuara për mësimnxënie për të rriturit.

A mund të ndërmjetësojë komisioni juaj mes MASHT-it dhe Rektorit të Universitetit?

Jo në këtë moment. Ne e respektojmë autonominë e Universitetit të Prishtinës si edhe kompetencat e MASHT-it përkitazi me arsimin e lartë. Ne gjithashtu do ta presim vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me këtë çështje.

Çfarë është vlerësimi juaj për projektligjin për trashëgiminë kulturore dhe projektligjin për teatrot?

Projektligji për trashëgiminë kulturore është një draft shumë i dobët sepse nuk përfshin dispozitat konkrete që kanë të bëjnë me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave kulturore. Ne jemi duke pritur qeverinë që të dorëzojë projektin e rishqyrtuar dhe pastaj të japim mendimin tonë. Projektligji për teatrin është shumë i mirë. Megjithatë, nuk pajtohem me ndikimin që i dhurohet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbi teatrot. Unë besoj se institucionet kulturore duhet të kenë statusin e agjensioneve të pavarura publike.

Cila është pozita juaj lidhur me projektligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë?

Rinia duhet të jetë prioritet i institucioneve të Kosovës, gjë që tani nuk është rasti. Projektligji për rininë duhet të mira-

tohet sa më parë që të jetë e mundur. Qeveria e ka vonuar këtë projektligj pasi që nuk është pjesë e standardeve prioritare. Megjithatë, unë besoj se qeveria duhet të punojë si drejt standardeve ashtu edhe drejt drejtësisë sociale.

Çfarë roli mund ta ketë Kuvendi i Kosovës në ngritjen e profilit të rinisë dhe arsimit në debatin publik dhe agjendën politike?

Unë mendoj se Kuvendi duhet ta luajrolin kritikëndryshimin e perceptimit për arsimin duke e përcjellur qasjen evropiane. Arsimit duhet të bazohet në zhvillimin e kompetencave kyçe dhe shkathësive siç janë mendimi kritik dhe jo memorizimi i fakteve. Fatkeqësisht, institucionet e Kosovës kanë qasje të gabuar ndaj arsimit. Kosova po ballafaqohet me sfidën e transferimit të qasjes së UE-së në politika konkrete.

Cili është vlerësimi juaj për ndihmën e ofruar nga ASI për Kuvendin e Kosovës? a e keni ndonjë kërkesë për ASI-n?

Kuvendi ia ka borxh shumë prej arritjeve të veta në tri vitet e fundit përkrahjes së ASI-t. ASI mund të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes së Anëtarëve të Kuvendit për përgjegjësitë e tyre. Kuvendi nuk është vetëm një makinë për prodhimin e ligjeve. Ai ka obligim që ta mbajë qeverinë përgjegjëse si dhe të paraqesë zërin e qytetarëve.

Komisioni im në bashkëpunim me MASHT-in është i interesuar për organizimin e konferencave dhe seminareve me tema për arsimin dhe rininë. Ne do të mund ta shfrytëzonim shumë ndihmën e ASI-t për ngritjen e vetëdijes së publikut të Kosovës për standardet e arsimit të UE-së duke i ftuar ekspertët e

UE-së në konferencat tona. Së shpejti do të dal me propozime konkrete.

A mban komisioni juaj dëgjime të ekspertëve?

Patjetër. Më 10 shkurt kemi organizuar dëgjimin publik për projektligjin mbi teatrin ku ishin të ftuar të gjitha palët e interesuara. Ne jemi shumë të kujdesshëm në mënyrë që t'i përfshijmë të gjithë faktorët në procesin e hartimit të ligjit dhe do t'i përfshijmë rekomandimet e tyre në projektin e rishikuar të ligjit. Megjithatë, Komisioni nuk ka buxhet për të angazhuar ekspertët dhe hulumtuesit. Personalisht kam kërkuar nga Kryetari Daci që të caktohet buxheti por deri më tani nuk kam marrë përgjigje. Më lejoni t'ju siguroj se unë nuk do të heq dorë nga kjo çështje pasi që nuk do të jemi në gjendje të punojmë në mënyrë profesionale pa buxhet.

Cilat janë prioritetet legjislative të grupit parlamentar të PDK-së?

Ne i përkrahim prioritetet e Qeverisë sa i përket ligjeve që kanë të bëjnë me implementimin e standardeve. Mirëpo Kuvendi duhet ta miratojë ligjin për qeverisjen lokale dhe ligjin për financat lokale sa më parë që është e mundur. Pilot projektet nuk mund të fillojnë pa legjislacionin e duhur. Për këtë arsye është thelbësore që të krijohet infrastruktura e duhur për procesin e decentralizimit. Problemi është se Qeveria nuk mund ta bëjë këtë. Prioritetet e tjera të PDK-së janë ligjet që e përkrahin zhvillimin e ekonomisë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Cili është mendimi juaj për projektligjin mbi Komisionin e Pavarur për Media?

Ky projektligj është shembulli më i mirë se si opozita mund ta luajë rolin konstruktiv por edhe ilustrimi më i mirë i përfitimit reciprok nga bashkëpunimi i ngjishëm ndërmjet kosovarëve dhe bashkësisë ndërkombëtare. Verzioni i tanishëm i projektligjit do të krijonte ambient të përshtatshëm për kontrollin e mediave nga ana e Qeverisë. PDK-ja e ka kundërshtuar përbërjen e propozuar të Komisionit (7 anëtarë: 2 anëtarë të emëruar nga PSSP-ja, 1 nga Kuvendi i Kosovës dhe 4 nga shoqëria civile mirëpo të votuar nga Kuvendi). PDK-ja angazhohet për pavarësi të mediave nga politika. KPM do të ndërhynte në punën e medi-

ave publike dhe atyre private.

Jam shumë i kënaqur kur e shoh se letra të cilën e ka adresuar Kryetari i PDK-së Hashim Thaçi për PSSP-në dhe Ambasadorin Fieschi është marrë seriozisht dhe e ka nxitur Komisionerin e Përkohshëm për Media që të gjejë një zgjidhje tjetër. PDK-ja përkrahë të gjitha sygjerimet nga Komisioneri. Unë shpresoj se Komisioni relevant do t'i marrë parasysh këto rekomandime dhe Kuvendi do të miratojë projektligjin e rishikuar. Në fund, dëshiroj ta falemnderoj Ambasadorin Pascal Fieschi për bashkëpunimin e tij konstruktiv dhe vullnetin e tij që t'i ofrojë Kosovës një ligj të mirë.

Zbatimi i ligjeve të Kuvendit i diskutueshëm

Departamenti i OSBE-së për të drejta të njeriut dhe sundim të ligjit ka publikuar raportin mbi nivelin e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës përmes legjislacionit suplementar, me theks të veçantë në ligjet e shpallura gjatë viteve 2002-2003. Të gjithë Anëtarët e Kuvendit e kanë pranuar nga një kopje të raportit. Më 3 shkurt, për këtë raport është diskutuar gjerësisht në një mbledhje të përbashkët me të gjithë zëvendës ministrat e qeverisë.

Raporti e bën një vlerësim të përgjithshëm se implementimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës ka filluar me një vonesë të konsiderueshme, pas të cilës shumica e institucioneve ia kanë dalur që gradualisht t'i tejkalojnë vështirësitë fillestare. Ndërsa arsyet kryesore për vonesën mund të numërohen: mungesa e resurseve të mjaftueshme në zyrat ligjore të ministrive, si dhe përqendrimi në hartimin e legjislacionit të ri dhe jo në zbatimin e ligjeve që tanimë janë në fuqi. Raporti rekomandon forcimin e përgjegjësisë së degës ekzekutive të IPVQ-ve. Kjo do të mund të arrihej përmes themelimit të një mekanizmi mbikëqyrës për zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës përbrenda Zyres së Kryeministrit dhe me një mbikëqyrje të përforcuar periodike të parlamentit ndaj aktiviteteve të degës ekzekutive. Raporti gjithashtu rekomandon një rregullim preciz të llojeve të akteve normative në Kosovë, hierarkinë për to, dhe organet përgjegjëse për nxjerrjen e tyre me miratimin e Ligjit për aktet normative. Raporti mund të gjendet në webfaqen në vijim www.osce.org/kosovo/documents

Ngjarjet e kohëve të fundit

Presidenti iu drejtua Kuvendit me fjalimin vjetor

Më 26 janar 2005 presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova ia drejtua Kuvendit me fjalimin vjetor. Duke folur në ditën e parë të seancës plenare të dhjetorit, Presidenti e shprehu besimin e tij në rritjen e vazhdueshme ekonomike në Kosovë, dhe ka deklaruar se arritja e pavarësisë do të jetë prioritet i Qeverisë. Ai e ka theksuar përkushtimin e Qeverisë për implementimin e standardeve dhe për integrimin e minoriteteve. Presidenti Rugova më tej ka thënë se qeveria do ta shqyrtojë themelimin e përfaqësimit diplomatik të Kosovës në disa shtete europiane dhe Shtetet e Bashkuara. Në fjalim nuk është përmendur dhuna e marsit të vitit 2004.

Qeveria e finalizon programin, prioritetet legjislative dhe Rregulloren e Punës së vet

Gjatë seancës plenare të 22-23 dhjetorit 2004 Kuvendi i Kosovës ka debatuar për projekt programin e qeverisë duke i përfshirë prioritetet, politikat dhe strategjitë e qeverisë për tri vitet e ardhshme. Anëtarët e Kuvendit nga koalicioni qeveritar si dhe nga opozita formuluan shumë sygjerime për projekt dokumentin. Pas analizimit të të gjitha të dhënave dhe propozimeve, qeveria e ka botuar programin dhe prioritetet e veta, një dokument gjithëpërfshirës që i ka 30 faqe. Qeveria gjithashtu e ka miratuar "Agjendën legjislative" për vitin 2005, një regjistër të 122 ligjeve që do t'i dorëzohen Kuvendit deri në fund të vitit 2005, duke i përfshirë këtu 20 ligje që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me planin për implementimin e standardeve. Më 1 shkurt Qeveria e ka aprovuar Rregulloren e punës së vet, siç është kërkuar me planin për implementimin e standardeve. Duke e pasur parasysh përvojën e funksionimit të qeverisë së mëparshme dhe praktikën më të mira nga Rregulloret e punës të qeverive të tjera të dhëna nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare, rregullorja e re qeveritare e punës është qartë, gjithëpërfshirëse dhe e menduar mirë. Rregullorja e përcakton bashkëveprimin midis kryeministrit dhe ministrave, publikimin e akteve ligjore qeveritare, bashkërendimin dhe planifikimin e punës së qeverisë, marrëdhëniet me Kuvendin dhe trupat dhe organizatat e tjera të IPVQ-ve. Që të tri dokumentet mund të barten nga web faqja e Kryeministrit: <http://www.pm-ks.gov.net/index.php?lang=en>

Kuvendi mban seancën plenare; Kryesia vendosë për financimin e partive

Në seancën e vet plenare të mbajtur më 23 shkurt, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar legjislacionin përkitazi me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës (BKK) për vitin 2005 dhe atë për lirinë e asocimit në OJQ, në mes tjerash. Kryesia e Kuvendit, më 1 mars, e ka miratuar formulën për shpërndarjen e BKK-së për financimin e partive politike me ç'rast çdo entitet politik i përfaqësuar në Kuvend do ta pranojë shumën që do të jetë në proporcion me numrin e ulëseve që i kanë. Formula e tanishme paraqet një përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me formulat e miratuara në vitet e kaluara, posaçërisht në atë se nuk bëhet dallim midis 20 ulëseve të rezervuara dhe 100 ulëseve të tjera të Kuvendit.

LSKM bën publik qëllimin e vet që të fillojë me pjesëmarrjen në IPVQ

Lista serbe për Kosovë dhe Metohi (LSKM) e ka bërë publik qëllimin e vet për të filluar pjesëmarrjen në IPVQ dhe ka kërkuar nga qeveria në Beograd dhe Këshilli shtetëror për Kosovën që ta qartësojë pozicionin e vet lidhur me këtë çështje. "Ne po kërkojmë para se të gjithash mendimin e Kryeministrit Koshtunica, sepse ai ishte kundër që sërbyt e Kosovës të marrin pjesë në Zgjedhje" tha anëtari i LSKM Ranxhel Nojkiq. LSKM pohoi se objektivat e përbashkëta do të ishin kushtet e jetesës për komunitetin e tyre por edhe të dëshmohej se standardet nuk po respektohen dhe se objektiva parësore e shqipëtarëve të Kosovës është e paarrtshme. LSKM do ti bashkangjitet grupeve punuese për decentralizim nëse përgjigja e zyrtarëve nga Beogradi vonohet.

Kur është kërkuar nga ai që të komentojë lajmet, Sllavisha Petkoviq, udhëheqës i Iniciativës Qytetare Sërbe (IQS) dhe Ministri për Kthim dhe Komunitete cilësoi vendimin e LSKM si një manovrim pasi që LSKM ka sjellë shumë dëme me mospjesëmarrjen e saj in zgjedhje. Duke patur parasysh përgjigjen negative ndaj iniciativës të këshilltarit të Kryeministrit, mbetet të shihet nëse LSKM do të marrë pjesë. Qeveria e Kosovës, nga ana e saj ka mirëpritur gadishmërinë e LSKM ti jap fund bojkotit dhe ftoi anëtarët e saj të demonstrojnë vullnetin e tyre që të marrin pjesë me hapa konkret dhe të shikojnë votuesit e tyre në Kosovë dhe jo në Beograd.

Qeveria dhe Komunat përmes një letre të hapur ftojnë për kthim

Më 25 shkurt, Kryeministri së bashku me ministrat që kryesojnë gjashtë grupet punuese mbi Standardet ishin nikoqirë të takimit me temën "Standardet dhe Komunat", në të cilin morrën pjesë kryetarët e kuvendeve komunale, yvendës kryesuesi i të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Koordinatori i UNMIK-ut për standarde dhe përfaqësuesit e grupit të kontaktit. Në takim u konkludua se nuk ka arsytim për tu mos u implementuar standardet në nivelin komunal dhe se do të ketë pasoja për komunat të cilat nuk i përbushin detyrat.

Duke vënë theksin e veçantë mbi kthimin si një prej standardeve kryesore, takimi arriti kulmin me lëshimin në qarkullim të letrës së hapur e cila fton për kthim të personave të zhvendosur në Kosovë. Duke përmendur në vijim edhe 'përgjegjësinë kryesore' që bartë komuniteti shumicë ndaj pakicës serbe, kërkesa për lirinë e pasurisë së uzurpuar pronarëve të tyre dhe kërkesa për respektimin e monumenteve fetare, apelohej tek të zhvendosurit që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të integrohen në shoqërinë e Kosovës.



ORA kritikon projektligjin për Buxhetin e Kosovës për 2005

Gjatë seancës plenare të mbajtur më 28 janar 2005 Kuvendi miratoi në parim gjatë leximit të parë projektligjin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për 2005. Në emër të partisë politike ORA, Veton Surroi parashtroi shtatë kritikata kryesore ndaj projektligjit të propozuar nga Qeveria

Veton Surroi, Kryetar i ORA-s



1. KONTINUITETI

Buxheti i propozuar është në fakt kontinuitet i buxheteve të mëparshme të miratuara nga Kuvendi i mëhershëm. Karakteristikë themelore e këtij buxheti është mbulimi i nevojave bazike administrative të Kosovës, në fazën e vet emergjente. Buxheti i mëhershëm nuk siguroi zhvillim ekonomik të Kosovës e as përbushje të nevojave, posaçërisht në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë; as ky nuk ka arsye ta bëjë këtë gjë.

2. KONTEKSTI I POLITIKAVE

Meqë është vazhdimësi i buxhetit të trashëguar, ai i ka të trashëguar edhe të metat themelore:

- Nëse mbështetet në të njëjtat të hyra si edhe buxheti i kaluar, atëherë, kjo do të thotë se Kosova mbetet në të njëjtin qark vicioz ku buxheti mbushet nëpërmjet të mallrave

të doganuara, gjë që do të thotë se do të mbushet për aq sa ka shpenzim të mallrave të importuara. Kjo do ta godasë nga njëra anë prodhuesin vendor, e nga ana tjetër nuk do të ndihmojë në ngritjen e kapacitetit të vendosjes së sundimit të ligjit në marrëdhëniet e brendshme ekonomike në Kosovë -KEK-u trajtohet si shfrytëzues buxhetor, dhe këtu vazhdon të mbetet Qarku vicioz i të ushqyerit të KEK-ut dhe pengim të ristrukturimit të tij.

- Projekt buxheti reflekton aktivitet të njëjtë, apo më të vogël ekonomik në Kosovë, sepse parashihet pothuaj të njëjtat të ardhura si vjet.

Implicite, kjo do të thotë se projektbuxheti nuk reflekton synimet e Programit qeveritar për ringjallje ekonomike në Kosovë.

3. DEFICITI

Projektbuxheti paraqitet me deficit të programuar prej 105

milionë Eurosh, që duhet të mbulohen nga para të gatshme (Dividendë e PTK dhe kursimet e mbajtura të Qeverisë). Ky është një keqpërdorim i mjeteve të mundshme zhvillimore. ORA mendon se Kosovës urgjentisht i nevojitet një Fond Zhvillimor i cili do të hapte vende të reja të punës në sektorin privat, bujqësi, dhe ndërmarrje të vogla e të mesme, me mjete të cilat nuk do të përdoren nga Qeveria apo buxheti i saj, por nga një entitet i veçantë që do ti fuste këto para në qarkullim brenda sistemit banker të Kosovës me sistem kreditimi të dedikuar dhe të kushtëzuar për punë e zhvillim.

4 BILANCI I PRANIM DORËZIMIT

Meqë Qeveria e tanishme, dhe Kuvendi i tanishëm nuk pranoi iniciativën tonë që të bëhet një bilanc i pranimit-dorëzimit me Qeverinë e kaluar, ne vetëm mund të supozojmë se çka janë shpenzimet kapitale, apo në mallrat të prezentuara në këtë projektbuxhet.

Ajo çka ishte evidente nga Qeveria e kaluar ishte pak punë dhe shumë vetura e shpenzime të ngajshme.

Sugjerojmë që para deputetëve të paraqitet raporti i veturave zyrtare të trashëguara nga Qeveria e kaluar, dhe numrin që planifikon kjo Qeveri të blejë brenda kuotës buxhetore të "mallrave dhe shërbimeve".

5. PUNËSIMI, ARSIMI, SHËNDETËSIA

Projekt buxheti i vitit 2005 vazhdon me trendin e rritjes së të punësuarve në administratë.

Kërkojmë që ky trend të kthehet prapa, dhe në projekt-provizimin e ri Qeveritar, në bazë të udhëzimeve të institucioneve financiare ndërkombëtare të na jepet raporti i parashikimit të zvogëlimit të të punësuarve në administratë, dhe rebalansimi i mjeteve të punëtorëve të administratës drejtpërsëdrejti në fushën e arsimit dhe shëndetësisë.

6. LIGJET, KOMPETENCAT

Ky projektbuxhet nuk ka marrë parasysh efektet e ligjeve të reja dhe kompetencave të reja me të cilat do të pajiset Kosova. Siç pamë në dy ditët e kaluara, ky Kuvend në mënyrë të papërgjegjshme dhe kundërpcedurale miraton projektligje pa pasur një përshkrim të kostos së tyre buxhetore.

Qeveria do të duhej të darkordohej së bashku me Kuvendin lidhur me ligjet dhe kompetencat që e presin Kosovën dhe ti integrojë ato si kosto në projektbuxhetin e ardhshëm.

7. JOTRANSPARENCA

Kuvendi nuk e aprovoi iniciativën tonë që të rivlerësohen shpenzimet buxhetore të Qeverisë së kaluar dhe të shohë keqpërdorimin eventual të tyre.

Kjo për fat të keq krijon klimën e mosndëshkimit. Përgjegjshmëria ndaj parasë publike u pa që në muajin dhjetor kur kjo qeveri shpenzoi mbi 160 milionë euro brenda 20 ditësh.

Mungesa e transparencës lejon jo vetëm këtë, por edhe mundësinë që paratë e shpenzuara të mostë jenë të dedikuara për Kosovën por për xhepat privat.

Deklarata e kryeministrit drejtuar qytetarëve të Kosovës

Qytetarë të Kosovës,

Lufta e fundit në Kosovë la së paku 12 000 të vrarë dhe qindra mijëra të tjerë të fyer e të përdhunuar. Më shumë se 120 000 shtëpi dhe prona të djegura dhe më se një milion qytetarë të larguar me forcë nga shtëpitë e tyre në një kampanjë brutale të spastrimit etnik.

Lufta jonë për liri ka kërkuar tepër sakrifica.

Edhe sot e kësaj dite me mijëra familje përballen me dhimbjen dhe ankthin për më të dashurit e tyre fati i të cilëve nuk dihet. Dhe ne ende nuk e kemi përfunduar punën.

Në anën tjetër, ne e kemi kaluar një rrugë të gjatë që nga viti 1999 dhe tani jemi afër arritjes së pavarësisë sonë. Kjo do të jetë arritja më e madhe për Kosovën dhe në të njëjtën kohë edhe fillimi i rrugëtimit drejt Unionit Evropian dhe NATO-s.

Në tre muaj qysh se qeveria të cilën unë e udhëhoqa e dha betimin, ne kemi bërë përpime të cilat pakkush i ka pritur, sidomos në drejtim të përmbushjes së standardeve të cilat i dizajnoj bashkësia ndërkombëtare në mënyrë që të ecet përpara drejt statusit final të Kosovës. Ky status për ne ishte dhe mbetet vetëm pavarësia e plotë dhe sovraniteti i vendit. Ne kemi treguar fuqishëm se do të punojmë gjithmonë me përkushtim drejt krijimit të një shteti demokratik, tolerant të prosperuar dhe të respektuar si nga vetë qytetarët tanë ashtu edhe nga e gjithë bota mbarë. Gjatë kësaj kohe bashkësia ndërkombëtare na ka kuptuar drejt dhe ka bashkëpunuar me ne në mënyrë më konstruktive. Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Zoti Jessen-Petersen ka qenë një bashkëpunëtor shumë

i mirë imi dhe një mik i madh i Kosovës.

Qytetarë të Kosovës, asgjë nuk guxon ta ndalë rrugëtimin tonë tani. Secili prej nesh, cilidoqoftë duhet të jetë i gatshëm që të bëjë sakrificën e duhur në mënyrë që më në fund pas shumë shekujsh vuajtjesh e sakrificash populli dhe vendi ynë ta arrijë mëvetësinë e merituar.

Sot unë jam thirrur të bëj edhe një sakrificë gjë që kurrë nuk kam besuar se do të ndodhë. Tani jam informuar se Tribunali i Hagës e ka lëshuar një akt padi kundër meje.

Fillimisht më duhet të them para jush se jam i pafajshëm për çfarëdo krimi që më ngarkohet. Këtë e them sepse unë para së gjithash jam përgjegjës para popullit tim. Të gjitha veprimet e mia në luftë kanë qenë në pajtim me moralin e luftës, me rregullat ndërkombëtare dhe me kodin e burrisë. Më parë thash se kam punuar gjatë gjithë kohës për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të denjë për të qenë pjesë e botës së përparuar. Kjo në vetvete do të thotë edhe bashkëpunim me drejtësinë ndërkombëtare sado e padrejtë të jetë në këtë moment. Ndjehem i fyer me këtë proces, ndjehem i prekur thellë, ndjej se po më largojnë nga puna në kohën kur isha duke e dhënë maksimumin për vendin tim por më duhet ta pranoj për hir të vendit dhe për hir të gjithë neve.

Unë jam një njeri i Kosovës dhe me dëshirë sakrifikohem për vendin tim.

Prandaj unë e pranoj këtë barrë. Në të njëjtën kohë kërkoj edhe nga ju që ta pranoni këtë fakt. Kërkoj nga ju të gjithë që të pranoni diçka që është gati e pamundshme për t'u pranuar por bëjeni këtë për t'i bërë nder vendit dhe kombit. Kërkoj nga ju që të mendoni për interesin madhor të vendit.

Bashkësia ndërkombëtare e ka bërë një gabim të madh kur e ka krijuar një tribunal i cili i trajton luftëtarët e lirisë njësoj me agresorët që shkatërruan popuj të tërë dhe e kthyen rajonin në gërmadha. Dëshiroj të besoj se ka qenë një gabim pa dashje. Dëshiroj të besoj se ata nuk kanë dashur që kjo të ndodhë. E di që shumica prej tyre do të jenë

të shokuar po aq sa jam unë dhe po aq sa jeni ju. Kjo që është përgatitur buron nga gënjeshtat e përgatitura në Beograd dhe nga pazarllëqet që disa i kanë bërë me qeverinë e serbisë për t'i ekstraduar kriminelët serbë. Ky është një gabim i bërë nga disa njerëz që nuk e dinë fare se çka ka ndodhur në Kosovë dhe që nuk duan t'ia dinë se çfarë do të ndodhë këtu në të ardhmen.

Sidoqoftë, unë e di se nuk jam përgjegjës për ato që akuzohem dhe poashtu e di se edhe gjykata do ta vërtetojë këtë.

Në ditët që do të vijmë unë do të konsultohem me kolegët e mi dhe me bashkësinë ndërkombëtare për rolin tim në të ardh-

men. Çfarëdo që kam bërë në jetën time ka qenë në shërbim të Kosovës. Këtë jam duke e bërë edhe sot duke pranuar diçka që nga aspekti i drejtësisë është e papranueshme.

Tani dua t'iu falënderoj të gjithëve për mbështetjen e vazhdueshme që ma dhatë në kohët më të vështira. Dua ta falënderoj Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, dua t'iu falënderoj kolegët të Koalicionit për punën e tyre, dua ta falënderoj Presidentin Rugova dhe Kryetarin e Kuvendit Daci për mbështetjen e tyre të vazhdueshme. Falënderime të sinqerta poashtu iu dërgoj zotit Jessen-Petersen dhe Gjeneralit de Kermabon për

miqësinë e sinqertë që treguan ndaj meje.

Unë sot jap dorëheqje nga posti i Kryeministrit të Kosovës. Nga kolegët e mi të koalicionit qeverisës kam kërkuar që ta vazhdojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ta forcojnë koalicionin qeverisës. Vetëm në këtë mënyrë Kosova do të arrijë t'i përmbushë aspiratat e veta në afat sa më të shkurtër.

Kjo është edhe një ndërprerje në rrugën tonë drejt lirisë, demokracisë dhe sovranitetit, por iu premtos se asgjë dhe askush nuk mund ta ndalë rrugën tone drejt pavarësisë

Mirupafshim dhe faleminderit.

Reagimi i UNMIK-ut

"Unë jam informuar për vendimin e Ramush Haradinajt që të largohet menjëherë nga posti i kryeministrit të Kosovës. Unë, natyrisht, e respektoj vendimin e tij, por nuk mund ta fsheh faktin se largimi i tij do të lerë një hendek të madh. Falë lidershit dinamik, përkushtimit të fortë dhe vizionit të Ramush Haradinajt, Kosova është sot më afër se çdoherë tjetër më parë për ta arritur aspiratën e vet në vendosjen e statusit përfundimtar. Personalisht, unë jam i pikëlluar që nuk do të punoj më me partnerin dhe mikun tim të ngushtë.

Me vendimin e tij të sotëm, Z. Haradinaj edhe njëherë ka vënë interesat e Kosovës mbi interesat e veta personale. Është me rëndësi që populli i Kosovës të përgjigjet me të njejtin dinji-tet dhe pjekuri çfarë e tregoi Ramush Haradinaj.

Unë e kuptoj ndjenjën e tronditjes dhe zemërimit me këtë zhvillim. Unë i bëj thirrje, megjithatë, popullit të Kosovës që t'i shprehë ndjenjat e veta në mënyrë paqësore. Një përgjigje

e dhunshme nuk do ta ndihmojë Kosovën. Kjo do t'iu shërbejë vetëm interesave të atyre që janë të përcaktuar për ta bllokuar rrugën e Kosovës përpara. Kjo do të ishte një kthim i madh prapa në gjithçka që ka arritur Kosova gjatë kohëve të fundit dhe do t'iu prishte të gjitha të arriturat e fundit, veçanërisht ato që janë bërë gjatë lidershit të Z. Haradinajt.

Vendimi i marrë nga Z. Haradinaj për të bashkëpunuar me Tribunalin, përkundër bindjes së tij të thellë për pafajësi, megjithëse i vështirë për të, familjen, Kosovën dhe për shumë nga miqtë e tij dhe partnerët, përfshirë edhe UNMIK-un, është në të njëjtën kohë një shembull i rritjes së maturisë politike të Kosovës si anëtare e përgjegjshme e komunitetit ndërkombëtar. Unë besoj se Z. Haradinaj edhe më tej do të jetë në gjendje t'iu shërbejë Kosovës për një të ardhme më të mirë për të cilën ka sakrifikuar dhe kontribuar aq shumë.

Është me rëndësi që të gjithë ne ta ruajmë gjakftohësinë dhe dinjitetin gjatë këtyre ditëve



të vështira. Konform Kornizës Kushtetuese dhe rregullores së aplikueshme, Zëvendës kryeministri i Kosovës përkohësisht do ta drejtojë qeverinë. Ndërkohë, unë do të punoj me liderët politik të Kosovës që të sigurohemi se, sa më shpejtë që të jetë e mundur, të kemi një qeveri në funksion e cila do të mund të vazhdojë, pa shtyrje dhe përçarje, punën e cila do ta çojë Kosovën drejt një rishikimi gjithëpërfshirës të standardeve këtë verë dhe drejt bisedave për statusin më vonë gjatë këtij viti. Unë u bëj thirrje të gjithë liderëve

politik që të tregojnë përgjegjësi për t'iu bërë bashkë në ndjekjen e përbashkët të interesave më të mëdha të Kosovës në këtë moment qenësor. Së bashku, ne mund t'iu tejkalojmë vështirësitë e tanishme, dhe të vazhdojmë të ecim përpara në rrugën evropiane të Kosovës drejt një Kosove të lirë, demokratike, multietnike, stabile dhe prosperuese."

Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm

Søren Jessen-Petersen

8 mars 2005

Parlamenti European debaton procesin drejt statusit final të Kosovës

Në Bruksel, në Parlamenti European u mbajt debati qëndror që iu adresua procesit të definimit të statusit final të Kosovës. Më 25 janar 2005, Komisioni për Punë të Jashtme pranë Parlamentit European organizoi një Degjim Publik mbi Kosovën në të cilën pati shumë pjesëmarrës. Pas miratimit të disa rezolutave mbi Kosovën gjatë viteve të fundit, dhe mbatjes së disa dëgjimeve publike në të kaluarën ku kanë marrur pjesë edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, Parlamenti European edhe kësaj here përmes këtij dëgjimi shton angazhimin e vet në Kosovë.

Franklin De Vrieze



Një prej panelistëve kryesor që iu adresua Parlamentit European ishte z.Misha Gleni, autor i disa librave mbi Ballkanin. Ai theksoi që viti 2005 dhe 2006 do të jenë 'vitet e kërstitmave' gjatë të cilave historia e rajonit si në librin "Fuqia e barutit në Europë" ose do të përfundojë ose nëse negociatat mbi statusin final dështojnë do të ketë rrezik nga shpërthimi i dhunës dhe intensifikimi i problemeve shoqërore siç janë varfëria dhe krimi i organizuar. Çdo debat mbi të ardhmën e Kosovës e sheh esenciale garantimin e sigurisë së sërbevë, aq më

tepër kur këto dy komunitete, ajo shqiptare dhe sërbe, janë të ndërlidhura më tepër se që mund të duket në shikim të parë. Meqë negociimi i statusit final nuk mund të jetë stabil pa pjesëmarrjen e Qeverisë nga Beogradi, pohon z. Gleni, puna kryesore që duhet bërë është që të kërkohet nga Beogradi që të plotësojë kërkesat e bashkësisë ndërkombtare për rajonin. Ai tërhoqi vërejtjen kundër ndarjes së Kosovës, ngaqë sërbet që jetojnë në pjesë jugore të lumit Ibër do të shpërnguleshin në drejtim të Preshevës dhe Bujanovcit me ç'rast do të destabilizohej

situata edhe ashtu e ndjeshme atje. Dhe derisa po theksonte që mospërfshirja e Beogradit në proces do të krijonte destabilitet afatgjatë, z. Gleni gjithashtu përkujtoi që Sërbia nuk paraqet bllokadë të gurtë duke e cituar apelin e kundërt të Presidentit Tadiq nga Kryeministri Kosh-tunica për të dalë në zgjedhjet e tetorit 2004.

Z. Gleni tha që është i nevojshëm angazhimi me Sërbinë dhe ai ishte në favor të një kriteri më fleksibil nga ana e BE-së për hyrjen në BE të Ballkanit Perëndimor.

Profesori Jacques Rupnik nga Centre d'Etudes et de Recherches Internationales (CERI) foli për procesin e regresionit jo vetëm në Kosovë, të demonstruar me ngjarjet e Marsit 2004, por edhe në Beograd ku elita politike nuk posedon vullnetin e mirë për t'ju adresuar kësaj çështjeje. Z.Rupnik përkujtoi takimin e tij me të ndjerin ish-kryeministrin e Sërbisë Zoran Gjingjiq për të cilin Kosova ishte "një kaptinë e mbyllur – por nuk mund ta them haptas meqë kushtet politike akoma nuk lejojnë një gjë të tillë." Ndërkohë që pas Zgjedhjeve të Dhjetorit 2003 kur Partia Radikale fitoi shumicën e votave, konteksti politik u komplikua akoma më tepër. Z. Rupnik u pajtua që trajtimi ndaj minoritetit sërb në Kosovë paraqet sfidën më mad-

hore për bashkësinë ndërkombtare për të ofruar një zgjedhje të qëndrueshme. Por ai gjithashtu theksoi që protektorati është "infantilizuar", meqë Kuvendit të Kosovës i mungojnë kompetencat themelore mbi buxhetin dhe tatimin.

Z. Rupnik avokonte "pavarsinë e kushtëzuar" për Kosovën. Mes kushteve tjera ai përmendi vullnetin që të gjitha forcat politike të dënojnë dhunën dhe çfarëdo ndryshimi të kufinjëve (një Anschlussverbot me Shqipërinë) dhe sigurinë e minoritetit sërb, përfshirë këtu edhe të drejtën e pjesëmarrjes në procesin politik. BE-ja duhet të mbajë premtimin e "hyrjes në orbitën Europiane në çfardo forme", duke ofruar kështu prospekte më të mira sesa agjendat nacionaliste.

Dr. Nicholas Whyte nga Grupi Ndërkombtar i Krizave (ICG) prezantoi konkluzionet nga raporti i fundit mbi Kosovën. Duke aluduar në pamundësinë e vazhimit të status quos ai përmendi stagnimin ekonomik të shkaktuar nga jodefinimi i pozitës ligjore dhe kushtetuese të Kosovës si dhe rrezikun nga dhuna e mbrendshme. Për këtë, tha ai, të gjitha palët duhet filuar menjëherë të punojnë në krijimin e një shteti të pavarur të Kosovës i cili garanton të drejtat e minoriteteve. Sërbia duhet të pranojë realitetin e ri dhe faktin që Kosova nuk mund të kthehet

më nën sundimin e Beogradit, tha ai, ndërkohë që Kosova duhet të mbrojë minoritetet si një kusht i patjetërsueshëm për pavarësinë.

Raporti i Grupit Ndërkombtar të Krizave parasheh një sërë ngjarjesh dhe vendimesh që do të çojnë drejt një Kosove të njohur ndërkombtarisht kah mesi i vitit 2005. Grupi Ndërkombtar i Krizave avokon në atë që Grupi i Kontaktit duhet të caktojë katër rregulla që iu duhet përmbajtur para përcaktimit të statusit final të Kosovës siç janë: mbrotja e të drejtave të minoriteteve në Kosovë që paraqet një është

çështje nga e cila varet pothuajse i tërë progresi, dhe se nuk do të ketë kthim të Kosovës nën sundimin e Beogradit dhe as ndarje apo bashkim të Kosovës me Shqipërinë apo me ndonjë nga shtetet apo territoret fqinje. Njëkohsisht, një i Derguar Special duhet të emërohet nga Sekretari Gjeneral i OKB-së që të fillojë konsultimet mbi përmbajtjen e një zgjidhjeje dhe procesi përmes së cilës do të duhej zbatuar ato. Nga mesi i vitit 2005 OKB-ja do të vlerësojë përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për demokraci, qeverisje të mire dhe plotësimin e standardeve për të drejtat e njeriut. Në rast

të vlerësimit pozitiv, I Dërguari Special duhet të përgatisë draft tekstin për -- 'Marrëveshjen mbi Kosovën' -- dhe detajet e një konference ndërkombtare në lidhje me këtë. Kuvendi i Kosovës, me ndihmën ndërkombtare duhet të fillojë përpilimin e kushtetutës, që do të ofronte respektim dhe mbrojtje të plotë për minoritetet. Dhe teksti i kushtetutës nëse pranohet nga konferenca ndërkombtare do të përbënte Marrëveshjen e propozuar mbi Kosovën.

Duke patur parasysh gjithë çfarë ndodhi në të kaluarën dhe pasiguritë e asaj se çfarë

do të ndodh në të ardhmën, ICG avokon krijimin e disa kufizimeve në lirinë e veprimit të një Kosove të pavarur, p.sh: mund të emërohen gjyqëtarë ndërkombtarë nëpër gjykatat superiore të Kosovës, ku palë të caktuara ndërkombtare do të siguronin që çështje të caktuara që kanë të bëjnë me të drejtat e minoriteteve dhe obligimeve të tjera mbi të cilat është arritur ujdia të shqyrtohen nga këto gjykata: Kosova do të mund të akomodonte një prezencë monitoruese ndërkombtare – të ashtuquajturën 'Misioni monitorues në Kosovë' – që do të t'i raportonte bashkësisë ndërkombtare



dhe do të jepte rekomandimet për masat që duhet ndërmarrë nëse Kosova i shmanget obligimeve. Pas ndërmarrjes së të gjitha këtyre masave, ICG-ja është në favor të mbajtjes së një konference tjetër ndërkombtare dhe miratimit të kësaj kushtetute përmes referendumit nga ana e qytetarëve të Kosovës. Të vetëdijshëm që Serbia – ndoshta edhe Rusia – do të refuzojnë të bashkëpunojnë me pjesë të caktuara të planit apo edhe me tërë planin, ICG avokon në atë që procesi i propozuar të mos ngel peng i këtij eventualiteti: situata reale në Kosovë është tejte e ndieshme, dhe status quo-ja shumë paqëndrueshme në shumë aspekte, për të lënë bashkësinë ndërkombtare që të lejojë që pjesë e së ardhmës së saj të jetë një pikë aq e paqëndrueshme. Ndërkohë që brenat serbe duhet patur parasysh, në veqanti ato që lidhen me statusin e minoritetit serb, Beogradit duhet tërhequr vërejtjen që “treni do ikën me apo pa ju”, dhe t’i inkurajojnë ata që të marrin pjesë në mënyrë që të arrihet një zgjedhje më e mire e mundshme.

Gjatë debatit, Anëtarët e Parlamentit Europian dukej të ishin në pajtim me propozimet e paraqitura. Sido që të jetë, disa nga Anëtarët e Parlamentit Europian shprehën dyshimet e tyre në lidhje me periudhën e paraqitur kohore. Swoboda (Gjermani) tha që është në favor të pavarësisë por që kushtëzimet nuk duhet hudhur në ujë. Vlerat Europiane duhet të jenë të respektuata dhe që historia e pasur e Kosovës të njihet (referime negative iu bën murale të vendosura në Kuvend gjatë shkurtit dhe marsit). Ai gjithashtu tërhoqi vërejtjen që zgjedhja e statusit të Kosovës, ndonëse e preferuar do të bëhet me apo pa involvi-

min e Beogradit. Deputeti Jelko Kacin (Sllovenia) theksoi që vetizolimi i serbëve të Kosovës dhe bojkotimi i zgjedhjeve nuk sjellë ndonjë zgjedhje. Kosovës i duhet qartësimi i perspektivës përmes një zhvillimi ekonomik. Ai avokonte një marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë mes Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnë e Hercegovinës që do t’ju mundësonte shqiptarëve dhe serbëve (Bosnja edhe Hercegovina) të intensivifikojnë bashkëpunimin ekonomik – që do të ishte i dobishëm edhe për diskutimet mbi statusin.

Z. Kim Freidberg, Këshilltari i të Dërguarit Special, bëri një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit në Kosovë, si dhe shtroi parashikimet e UNMIK-ut mbi atë çfarë e pret atë në të ardhmën. Ai përmendi të arriturat në lëminë e sigurisë, rindërtimin e shkollave dhe shtëpive të shkatërruara gjatë dhunës së Marsit 2004. Prioritetet e standardeve janë definuar dhe të gjitha do të përqëndrohen në minoritetet. Më shumë kompetenca po kalojnë tek IPVQ-të në lëmitë që nuk i përkasin sovranitetit. Njëkohsisht, politika e llogaridhënies parasheh sanksionet kundër zyrtarëve që në një mënyrë apo tjetrën nuk i kryejnë detyrat apo përpiqen të bllokojnë avancimet në lëmitë kyçe (si të drejtat e minoriteteve, liria e lëvizjes, kthimi i personave të zhvendosur, shërbime të barabarta për të gjithë, media përgjegjëse dhe siguri) Transferi i kompetencave është bërë edhe në lëminë e ekonomisë. Z. Freidberg përmendi që Kryeministri Haradinaj shumë shpejt ka dëshmuar veten në krye të një qeverie energjike dhe të vendosur për të bërë një progres të vërtetë në përgjithsi por edhe në avancimin e pozitës së minoriteteve. Z. Freidberg

dha shembujt e pjesëmarrjes së mangët dëshpruese të serbëve të Kosovës në këto procese.

Në vazhdim Z. Freidberg foli për vlerësimin tremujor që iu bëhet Implementimit të Standardeve në mënyrë që progresi i arritur të vlerësohet nga Grupi i Kontaktit dhe Këshilli i Sigurimit. Sa i përket vlerëimit të periudhës tremujore, që nga nëntori është arritur përparim i dukshëm por ngelet akoma shumë për të bërë, posaqërisht në lëmitë që kanë të bëjnë me kthimin dhe lirinë e lëvizjes. Në këtë kontekst z. Freidberg theksoi që mungesa e progresit të shkaktuar nga mospjesëmarja e serbëve të Kosovës, apo për shkak të bllokadës aktive të tyre nuk do të jetë barrë mbi supet e atyre që bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të arritur progres. Zgjedhja e statusit do të ndihmojë Kosovës dhe gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale, dhe gjithashtu do t’i mundësonte Beogradit të përqëndrohet në prioritetet e veta ekonomike dhe sociale, tha z. Freidberg. Qasja e qartë dhe orari i definuar bëjnë që pengesat të dalin në sipërfaqe. “Mundësia që përfundimisht po shohim Kosovën të ecën drejt një shoqërie multi-etnike, kjo nga që popullata shumicë e ka të qartë që rruga drejt zgjedhjes së statusit varet nga konsolidimi i të drejtave të minoriteteve. Ne besojmë që nevoja e kyqjes së minoriteteve në shoqërinë e gjithmbarshme është tanimë e njohur. Ne tani jemi dëshmitarë të përparimeve në procesin e decentralizimit që befasuan shumëkë, përfshirë këtu faktin që Kosova dhe Beogradi po bënin thirrje për një proces të tillë për një kohë të gjatë tanimë.” Z. Freidberg komentoi rrezikun e gjetjes së zgjedhjeve që nuk janë zgjedhje të denja si ndarja e territoreve. Ka gjasa që çdo pushtet pas sta-

tusit do të kërkonte një prezencë ndërkombtare për të siguruar stabilitet dhe levizje të sigurtë drejt integriteteve Europiane.

Z. Nebojsa Covic, Kryesues i Qendrës Koordinative për Kosovë dhe Metohi në kuadër të Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, theksoi që “mandati i UNMIK-ut nuk është të krijojë një shtet të pavarur”. Ai tërhoqi vëmendjen atyre të cilët pandehin të gjejnë zgjedhje për statusin e Kosovës pa pajtimin e Beogradit, ngaqë, sipas tij kjo nuk do të ishte një zgjedhje afatgjate. Ai gjithashtu vuri në pyetje vlerësimin e progresit të arritur të paraqitur nga Z. Skender Hyseni, këshilltar politik të Kosovës, i cili tha që çështja e pavarësisë është vetëm çështje kohe. Ai theksoi që pavarësia është çështje praktike, Kosova nuk ka qasje në kredi nga institucionet financiare ndërkombtare dhe nuk mund të angazhohet në procesin e bashkëpunimit me fqinjët. Pas pavarësisë, një arranzhman rajonal i llojit të Shengenit do të ishte i preferuar. Gjendja e padefinuar politike po shkakton ngritjen e tensioneve – tërhoqi vëmendjen z. Hyseni.

Deputetja Doris Pack (Gjermani), e cila kryeson Delegacionin për Marrëdhënie me Europën Juglindore pranë Parlamentit Europian, përkujtoi audiencën që BE-ja nuk e dëshiron Kosovën apo Serbinë në kuadër të saj përderisa problemet ngelin të pazgjedhura. Derisa po thekson se që nuk ka zgjedhje pa apo kundër Beogradit, ajo konfirmoi faktin që kufinj të Kosovës janë të definuar dhe nuk mund të ndryshojnë, dhe se pavarësia e Kosovës mund të arrihet vetëm pas kthimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe plotësimin të kushteve tjera.

Përprojekje të reja për ndërtimin e bashkëpunimit mes parlamenteve dhe organizatave të shoqërisë civile në rajon

Lulzim Peci, drejtor ekzekutiv
Instituti Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED)



Në dhjetor 2004, Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje Perëndim (EWPPP) nga Holanda në partneritet me disa OJQ të zgjedhura nga Ballkani Perëndimor filloi programin trevjeçar të quajtur Organet ligjvënës dhe Qytetarë-fuqizimi I institucioneve demokratike dhe të shoqërisë civile në Ballkani Perëndimor.

Grupet shënjestër janë anëtarët dhe stafi i parlamenteve si dhe përfaqësuesitë e organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

Anëtarët e Kuvendit të Kosovës, të cilët do jenë pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të projektit në Kosovë dhe në nivelin rajonal, do të zgjedhen në bashkëpunim dhe kryesues-

itë e grupeve parlamentare në kuadër të Kuvendit. OJQ-ja partnere e EWPPP në Kosovë është Instituti Kosovar për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim - KIPRED.

Programi synon t'ju ndihmojë parlamenteve dhe OJQ-ve të vendeve nga Ballkani Perëndimor që të përmirësojnë funksionimin e institucioneve dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e vendim-marrjes. Kjo ndihmë po vie në momentin kur tensioned ndëretnike, tendencat ekstreme të djathta politike, korrupcioni dhe krimi i organizuar paraqesin pengesat kryesore në ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky program do të funksionojë në vendet në rajon në nivelin

individual, dhe njëkohsisht do t'i adresohet rëndësisë së transparencës dhe komunikimit rajonal për një zhvillim efektiv demokratik. Komponenta rajonale është kyçe për suksesin e këtij programi, bazuar në faktin që krijimi i një krahu jugor stabil dhe paqësor është vital për të ardhmën e Europës.

Programi do të përbëhet edhe nga një konferencë qendrore të Parlamenteve dhe OJQ-ve, duke sjellur së bashku kështu ekipe rajonale të deputetëve dhe përfaqësuesve të OJQ-ve, për të shkëmbyer idetë dhe gjetur zgjedhje për çështjet me interes për rajonin: tryeza rajonale dyvjeçare: shkëmbime trilaterale rajonale të përbëra nga vizitat e përbashkëta të delegacioneve parlamentare dhe të shoqërisë civile të dy partnerëve tek partneri i tretë gjegjësisht vendi apo parlamenti fqinj.

Në një mbledhje mes EWPPP dhe partnerëve rajonal që u mbajt në Shkup më 13 janar 2005, u arrit marrëveshja e shkëmbimeve trilaterale rajonale. Parlamentet/organizata e shoqërisë civile nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi paraqeshin njërin trekëndësh dhe Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia një tjetër.

Temat që do të trajtohen gjatë shkëmbimit trilateral rajonal të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi do të kenë të bëjnë me çështjet e zakonshme që preokupojnë këto vende/parlamente siç janë: Procesi i Decentralizimit dhe Reformimi i Qeverisjes Lokale, Demokratizimi i Partive Politike dhe Institucioneve Qeveritare si dhe gjetja

e mundësive për të zhvilluar bashkëpunimin në nivelin rajonal.

Shkëmbimi i përvojave në këtë lëmi, si dhe mundësia që të ndëgjohen mendimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombtarë në një nivel rajonal dhe të lirë të dialogimit do të kontribonte në mësimet e nxjerra dhe do të sillte ide të reja për ata që merren me këto çështje për të mirën e popullatës së këtyre vendeve në rajon.

Përveq kësaj, ekipet e parlamenteve/shoqërive civile të vendit do të takohen rregullisht për të përcaktuar dhe monitoruar programin e planifikimit dhe implementimit. Ekipet e vendit do të marrin përsipër zgjedhjen e çështjeve për diskutim, përcaktimin e prioritetëve, sigurimin e pjesëmarrjes së balancuar në aktivitetet rajonale dhe përgatitjen e materialeve të programit.

Programi do të ofrojë një mundësi shtesë sidomos për liderët e rinjë parlamentarë që të pasurojnë njohuritë e tyre mbi çështjet ndërkombtare dhe të zhvillimit të politikave. EWPPP do të ofrojë stipendi të vogla për përfaqësuesitë e selektuar të sektorit të Parlamentit/OJQ-së që vijnë nga vendet në shënjestër për një vizitë pune në institucionet akademike të Holandës.

KIPRED-i pret bashkëpunimin e ndërsjellë me të gjitha palët me interes për të bërë programin një mjet përmes së cilit ndihmohet implementimi i "Standardeve për Kosovën" dhe avancimi në përgjithësi i nivelit të zhvillimit të demokracisë në Kosovë.

Intervistë me Z. Alexander Borg-Olivier, Këshillëtar ligjor i UNMIK-ut

“Ne duhet të punojmë si partnerë”

Intervistë nga Franklin de Vrieze dhe Uli Steinle OSBE

Ju i keni përcjellur zhvillimet në Kuvend që nga fillimi. Cilat mendoni ju se janë arritjet kryesore të Kuvendit gjatë tri viteve të kaluara dhe në çfarë mendoni ju se do të duhej të përmirësohej Kuvendi edhe më tej?

Kam qenë dëshmitar i një progresi të jashtëzakonshëm në ndërtimin e institucioneve në përgjithësi si dhe të Kuvendit në veçanti. Nuk është lehtë që një legjislacion i posaçërmë të fillojë së funksionuari në mënyrë efikase mu në fillim. Ka pasur shumë pengesa por unë mendoj se Kuvendit i takojnë meritat për themelimin e këtij institucioni dhe për përpjekjet që të arrihet edhe më shumë. Unë gjithashtu mendoj se Kuvendi ka zhvilluar një pjekuri. Jam i mahnitur me dinjitetin me të cilin Anëtarët e Kuvendit e trajtojnë punën e tyre.

Pasi që e këshilloni PSSP-në lidhur me shpalljen e projektligjeve, cila është përshtypja juaj për cilësinë e legjislacionit të miratuar?

Disa ligje nuk mund të shpallen sepse kanë pasur vështirësi të caktuara ose kanë kërkuar veprim të mëtutjeshëm. Do të thoja se ka ligje të cilësisë së arsyeshme dhe gjithëpërfshirëse që janë përgatitur me kontributin e duhur të ekspertëve. Dhe janë disa të tjera ligje që janë të mangëta dhe kjo ndoshta për arsye politike. Në të kaluarën, ndonjëherë ka pasur konkurrencë jo të shëndoshë midis Qeverisë dhe Kuvendit për atë se kush tregohet se punon më



shumë. Disa nisma ligjore për këtë arsye nuk janë përgatitur si duhet. Kjo pastaj e ka vonuar shqyrtimin e domosdoshëm të legjislacionit dhe reagimin e PSSP-së që të mos e nënshkruaj këtë legjislacion. Ka hapësirë për përmirësim ashtu që të përfshihet ekspertiza e domosdoshme gjatë përpilimit të ligjeve. Për shembull në fushën e ligjit komercial, është e qartë se Qeveria dhe Kuvendi kanë përfituar nga përkrahja

e ekspertëve. Por gjithashtu duhet të thuhet se nuk është e lehtë për Kuvendin që për një kohë kaq të shkurtër t'i pranojë si duhet të gjitha standardet europiane kushtetuese dhe mbi të drejtat e njeriut.

Sa janë të qëndrueshme ligjet që miratohen përbrenda kornizës së përgjithshme?

UNMIK-u ka ende përgjegjësi për atë që ndodhë në Kosovë. Për këtë arsye ne kemi detyrë

dhe përgjegjësi të qartë që të sigurohemi se ka qëndrueshmëri në legjislacion. Ne nuk mund të lejojmë të shpallen ligje të cilat krijojnë konfuzion si për gjyqtarët ashtu edhe për qytetarët. Ne nuk dëshirojmë që të lëmë pas vetes trashëgimi të dobët legjislative. Nuk them se nuk ka paqëndrueshmëri, mirëpo ne po mundohemi që t'i minimizojmë ato për aq sa dimë, ndonëse ne ndoshta dimë fare pak.

Ju thatë se UNMIK-u është përgjegjës për qëndrueshmërinë e legjislacionit në përgjithësi. A e përfshin kjo edhe legjislacionin e kompetencave të transferuara?

Po, patjetër. Cilido ligj që hyn në fuqi, fundja ai është në fuqi sepse është nënshkruar nga PSSP-ja, pa marrë parasysh nëse është për fushat e kompetencave të rezervuara apo të atyre të transferuara. PSSP-ja e merr përgjegjësinë e plotë për të thënë nëse ligji i caktuar është i gatshëm që të gjendet në librat ligjore.

Raporti i fundit i OSBE-së për implementimin e ligjeve ka treguar se mbetet të bëhet shumë sa i përket legjislacionit plotësues. Si reagoni ndaj këtyre konkluzioneve?

Ligji i cili është kaluar nga Kuvendi zakonisht ofron legjislacionin e gjerë kornizë për çështjen në fjalë. Mirëpo kur vie deri te implementimi i efektshëm kjo varet nga kapacitetet përbrenda ministrive për të ofruar akte të efektshme suplementare. Dhe është e qartë se nuk ka pasur përkushtim të njejtë për të vënë në funksion ligjet sikur ka pasur kur janë hartuar ato. Unë mendoj se do të ishte e dobishme që t'i kushtohet vëmendje më e madhe tërë fushës së akteve suplementare ligjore të cilat janë të domosdoshme për implementimin e ligjeve.

Në këtë kontekst ekziston një nevojë e madhe për mekanizmat e llogaridhënies. Unë nuk shoh interesim të madh tek një pjesë e Kuvendit për të ditur se çka ndodhë me ligjin pasi që ai kalon dhe miratohet. Juve ju nevojitet mekanizmi shqyrtues dhe monitorues për të parë nëse ligji është duke u implementuar ashtu siç ka qenë qëllimi i ligjdhënës, nëse zbatohet a është

ashtu siç është paraparë nga ligjvënësi, dhe nëse gjykatat veprojnë në përputhje me to ashtu siç duhe

Në çfarë mënyre mendoni se do të ndikohet kjo rrjedhë e legjislacionit nga situata e re kur kemi qeveri të koalicionit që ballafaqohet me opozitën në Kuvend?

Qeveria në njerën anë kundru-all opozitës parlamentare në anën tjetër në një parlament pasqyrojnë dukurinë e zakonshme që ndodhë në shumicën e demokracive. Modeli i tillë zakonisht jep rezultate më produktive. Ne e shohim një besim të ri tek Qeveria që nuk ka ekzistuar gjatë legjislaturës së parë. Në legjislaturën e parë Qeveria kurrë nuk ka qenë e sigurt çka do të ndodhte kur e dërgonin ndonjë çështje në Kuvend pasi që nuk ka pasur lojalitet dhe marrëveshje të qarta ndërpartiake.

Cilat kanë qenë problemet kryesore të identifikuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut në ato projektligje të cilat nuk janë nënshkruar ose i janë rikthyer Kuvendit për amendamentim?

Problemet kryesore të cilat ne i kërkojmë janë pajtueshmëria me Rezolutën 1244 të KS OKB-së dhe me Kornizën Kushtetuese si dhe respektimi i ndarjes së përgjegjësisë midis IPVQ-ve dhe PSSP-së. Kohëve të fundit jemi shumë më të butë ndaj kalimit të legjislacionit. Ne kujdesemi për cilësinë, por ne i japim përgjegjësinë Kuvendit sepse ai jep llogari për ligjet që i prodhon. Ne do ta ndalim legjislacionin vetëm nëse ai është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese ose me Rezolutën 1244 të KS OKB-së.

Pra ky është një ndryshim?

Ky është një ndryshim që lejon që IPVQ-të të rriten dhe mësojnë nga veprimet e veta në vend se ne të ndërhyjmë gjithmonë dhe të urdhërojmë se çka duhet bërë.

A pasqyrohet kjo gjithashtu edhe në komunikimin e përmirësuar me IPVQ-të?

Po, situata është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme dhe Kuvendi më nuk dëshiron që të kalojë ligje të cilat nuk shpallen. Pra të gjithë ne mësojmë nga gabimet tona dhe mendoj se tani ka procedura që po bëhen gjithnjë e më efektive. Ne punojmë shumë për të pasur një komunikim shumë më të mirë me Kuvendin dhe gjithashtu ekziston edhe vullneti nga ana e Kuvendit që kjo të arrihet. PSSP-ja e bëri prioritet që ne duhet të punojmë si partnerë, që duhet të jemi konstruktiv dhe kooperativ aq sa është e mundur. Jo shumë kohë më parë, brengat tona nuk merreshin parasysh ose ato nuk i komunikoheshin Kuvendit nga Qeveria, kështu që Kuvendi i fillonte diskutimet pa ditur gjë për vështirësitë. Ndoshta ne e kishim një pjesë të fajit që nuk ishim mjaft të efektshëm që shqetësimet tona nuk ishin të njohura për të gjithë.

Në mandatin e kaluar Kuvendi ka miratuar amendamente për Kornizën Kushtetuese. Si e shikoni ju këtë?

Kjo takimë është bërë ushtrim politik. Ne e kemi ditur se çka do të inicojë Kuvendi – një shqyrtim gjithëpërfshirës të Kornizës Kushtetuese. Ne gjithmonë ua kemi bërë të ditur se Korniza Kushtetuese ia bën të mundur Kuvendit që të bëjë ndryshime specifike dhe se ata mund t'i diskutojnë propozimet e tyre me UNMIK-un. Por që t'i lejohet Kuvendit të nisë me shqyrtimin gjithëpërfshirës pa u kërkuar të bëjë një gjë të tillë është veprim jo i duhur. Korniza Kushtetuese është nënshkruar dhe zhvilluar si rezultat i procesit gjithëpërfshirës konsultues që i ka përfshirë të gjitha komunitetet, faktorët kryesorë, KS e OKB-së, SP të OKB-së, SHBA-të dhe UE-në. Për këtë arsye ajo paraqet një ekuilibër të matur.

Njëra nga çështjet e diskutuara në raport me Kornizën Kushtetuese ka qenë zgjatja e mundshme e mandatit të Kuvendit nga tri në katër vite.

Para zgjedhjeve gati se ka patur koncensus se një gjë e tillë mund të ndodhë. Ne kemi treguar se nuk do të paraqiste problem nëse do të kishte marrëveshje përbrenda IPVQ-ve dhe kjo gati se ndodhi. Mirëpo pas lajmërimit për shqyrtimin e standardeve nga mesi i vitit e tërë dinamika ndryshoi. Tani nuk kishte më interes në IPVQ që të zgjatej mandati i Kuvendit që do të paraqiste një zgjidhje e përkohshme.

Shënime biografike:

Z. Borg-Olivier është jurist nga Malta dhe është Këshilltar Ligjor në UNMIK që nga viti 2000. Ai ka qenë motori shtytës sa i përket zhvillimit të Kornizës Kushtetuese. Një pjesë të madhe të jetës së tij profesionale ai ka shërbyer në Zyren për Çështje Ligjore në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork (që nga viti 1973) me specializim në rregullat dhe praktikat kushtetuese të Kombeve të Bashkuara.

Intervistë me z. Sherif Konjufca, zëdhënës i Kuvendit të Kosovës

Njohja sa më e mirë e punës e të gjithë anëtarëve të Kuvendit

Nga: Edmond Efendija, NDI

Me rastin e një prezantimi tuaj lidhur me rolin e zyrës suaj që e patët para deputetëve kohë më parë, janë dëgjuar disa vërejte nga deputetët e opozitës se ju nuk ndani kohë sa duhet për të mbuluar aktivitetet e opozitës?

uk ka ndonjë aktivitet i rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës të mos jetë përcjellë nga mediat dhe zyra jonë, pa bërë dallim ndërmjet deputetëve se a janë nga radhët e pozitës apo të opozitës. Në fakt Zyra për marrëdhënie me media dhe publikime, të cilën e udhëheq, për shumicën e aktivitetëve të kuvendarëve, pos që i fton mediat të raportojnë për ngjarjen e dhënë, çdo herë kujdeset që edhe të përgatit një kumtesë për atë aktivitet. Kështu veprojmë sepse jo çdo herë marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha mediave, por edhe për faktin që informacionet tona u shpërndahen edhe zyrave të shumta të mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë, madje edhe shumë organizatave joqeveritare, të cilat kanë shfaqur interes që të kenë informacione nga aktivitetet e Kuvendit të Kosovës. Informacionet tona shpeshherë u shërbejnë mediave, sidomos radiove dhe televizioneve, si kokë lajmi për kronikat që i kanë përgatitur për ndonjë aktivitet në Kuvend.

Gjithsesi i kuptoj shqetësimet e deputetëve, sepse nuk është e këndshme të jesh në opozitë. Punët e mëdha (mirë ose jo mirë) i bën Qeveria e shumicës dhe shumica në parlament, kurse opozitës i mbetet kritika dhe lufta politike për simpati në elektorat dhe për më shumë hapësirë në media, pikërisht për të shtuar ndikimin. Dhe

Zyra për marrëdhënie me media çdo herë është e gatshme që të pasqyrojë aktivitetin edhe të deputetëve nga opozita, por luftën politike dhe aktivitetet duhet t'i bëjnë vetë. Zyra jonë nuk e ka për obligim të shpikë aktivitetet të paqena ose të publikojë informacione që fyejnë dinjitetin e ndonjë deputeti, ministri apo të cilitdo qytetar. Zyra jonë gjithashtu nuk e ka për detyrë t'i ftojë mediat kur, ta zëmë, një deputet shkon për vizitë në ndonjë ministri a institucion tjetër, qoftë i vendit apo ndërkombëtar. Mediat, nëse e sheh të nevojshme, mund t'i thërrasë zyra e informacionit e atij institucioni.

Çfarë shërbimesh mund të presin deputetët nga zyra që drejtoni ju?

Siç e dini, Zyra për marrëdhënie me media pos që përcjell aktivitetet e përditshme në Kuvend, siç janë mbledhjet e Kryesisë, takimet protokollare të kryetarit të Kuvendit dhe të anëtarëve të Kryesisë, punën e komisioneve parlamentare etj. përcjell edhe aktivitetet e grupeve parlamentare, kur veprojnë brenda godinës së Kuvendit të Kosovës, por edhe aktivitetet e deputetëve të veçantë, qoftë brenda Kuvendit apo në terren. Informacionet për aktivitetet e kuvendarëve dhe të mekanizmave të Kuvendit, pos që shpërndahen në qindra adresa, publikohen edhe në faqen e Kuvendit në internet dhe në Buletinin e Kuvendit, i cili botohet në shqip, serbisht dhe turqisht.

Deputetët duhet të na njoftojnë për aktivitetet e tyre, që të mund t'i ftojmë mediat për të regjistruar atë aktivitet dhe zyra jonë të përgatisë informacion



shtesë për ngjarjen e dhënë. Çdo herë kemi qenë të hapur që qëndrimet e deputetëve dhe shkrimet e tyre autoriale për çështje të caktuara me interes t'i botojmë në Buletin dhe t'i publikojmë edhe në faqen e Kuvendit në internet. Ç'është e vërteta deputetët rrallëherë u janë përgjigjur kërkesave tona për të shkruar për ndonjë çështje, për të cilat kemi menduar se kanë kompetence profesionale. Kështu, ka ndodhur mbase për faktin se kanë qenë shumë të zënë, se më shumë kanë qenë të interesuar të komunikojnë me gazeta të përditshme dhe sidomos me media elektronike, por ndoshta edhe për faktin që zyra jonë nuk ka ndonjë fond që do tu paguante honorar autorëve të shkrimeve.

A ka pasur Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime,

ndonjë projekt që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në lidhje me rolin që ka Kuvendi dhe mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes?

Me Kornizën Kushtetuese nuk është paraparë mundësia e propozimit të ligjeve nga grupe qytetarësh. Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e qytetarëve munden, ndërkaq, të përgatisin projektligje dhe t'i shtyjnë ato nëpërmjet të ndonjë komisioni parlamentar, grupi parlamentar, apo të ndonjë deputeti të veçantë, të cilin do ta mbështesnin pesë deputetë të tjerë.

Një vështirësi tjetër janë vendet e kufizuara për përcjelljen e seancave plenare mysafirët dhe kërkesa e madhe për ndjekjen e tyre nga përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtarë në

Kosovë.

Kuvendi e ka miratuar vjet Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, që obligon për një transparence të institucioneve të vendit, kurse për një kohë jo shumë të largët do të fillojë edhe implementimi i Programit të arkivimit elektronik të dokumentacionit. Kjo do të jetë një dritare e hapur për media dhe qytetarë, lidhur me punën dhe dokumentacionin e Kuvendit.

Ç'është e vërteta, Kuvendin e kanë vizituar grupe të ndryshme qytetarësh, sidomos studentësh të vendit dhe të huaj dhe atyre u janë dhënë shpjegime për organizimin dhe punën e Kuvendit, por pos trajnimit të studentëve të Fakultetit Juridik dhe të seksionit të Shkencave politike. Nuk kemi realizuar ndonjë projekt të përpunuar për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve lidhur me punën e Kuvendit.

Me siguri që shumë organizata të shoqërisë civile do të dëshirojnë që të thonë fjalën e tyre para se të miratohen ligjet, por në web-faqen e Kuvendit, nuk janë të paraqitura projektligjet që shqyrtohen në Kuvend, nuk janë të dhëna agjendat e komisioneve parlamentare? Çka e pengon këtë?

Organizata të shoqërisë civile po bëhen përditë e më të zëshme në Kosovë dhe roli i tyre po shënon rritje të dukshme, me këtë edhe ndikimi në opinionin publik të Kosovës. Për shkak të vështirësive të krijimit të institucioneve të Kosovës në periudhën e pasluftës dhe vështirësive të funksionimit të tyre për shkak të përjashtimit për më shumë se dhjetë vjet të popullsisë shumicë nga jeta institucionale e Kosovës, rrallëkujt i ka rënë në mend për brengat e shoqërisë civile. Në pjesën e dytë të legjislaturës së kaluar, ndërkaq, komisionet parlamentare kanë

organizuar disa dëgjime publike, në të cilat janë dëgjuar edhe vërejtjet e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Siç e dini, seancat janë të hapura dhe transmetohen drejtpërdrejt nga televizioni. Gazetarët i ndjekin ato dhe gjerësisht informojnë për punimet e Kuvendit të Kosovës. Gjithsesi do të ishte mirë që qëndrimet e tyre lidhur me projektligje të caktuara të publikoheshin edhe para miratimit të ligjeve, por deri me sot nuk kemi pasur ndonjë kërkesë që qëndrimet e tyre të publikohen në faqen e Kuvendit në internet. Vështirësia tjetër do të ishte se për një gjë të tillë do të duhej të vendoste jo thjesht zyra jonë, por Sekretaria e Kuvendit.

Në fazën e parë të funksionimit të Kuvendit, kemi pasur rreptësisht të ndaluar nga sekretari (ndërkombëtar) i Kuvendit t'i ftojë mediat të regjistrojnë nga mbledhjet e komisioneve parlamentare, madje e kemi pasur të ndaluar të marrim pjesë edhe ne gazetarët e Zyrës për marrëdhënie me media! Pas miratimit të Rregullores së re të punës së Kuvendit, lejohet pjesëmarrja e mediave në mbledhje, nëse e kërkon kryetari i komisionit.

A është e vërtetë se gazetarëve që raportojnë nga Kuvendi nuk u jepet rendi i ditës deri në ditën e seancës?

Është e vërtetë se gazetarëve nuk u jepet rendi i ditës i detajuar i seancave, për shkak se çdo herë deputetët mund të vendosin që ai të ndryshohet në fillim të çdo seance. Por është e vërtetë gjithashtu se pas çdo mbledhjeje të Kryesisë së Kuvendit, kur përcaktohet rendi i ditës për seancën vijuese, ai u komunikohet të gjitha mediave, prandaj gazetarët të cilët sistematikisht e përcjellin punën e Kuvendit, çdo herë janë të njoftuar se çdo të shqyrtojnë deputetët në një seance të paralajmëruar.

A është Kuvendi i Kosovës i gatshëm për një "Komision drejtues të grave"?

Besa Luzha,
Fondacioni Friedrich Ebert (FES)

Duke u nisur nga përpjekjet e tërësishme për fuqizimin e pozitës së gruas në të gjitha sferat e aktiviteteve të shoqërisë në Kosovë, një gjë tjetër jo e panjohur për skenën politike më vie ndër mend sërish. Nevoja për formimin e një 'Komisioni drejtues të grave' në kuadër të Kuvendit të Kosovës, një grupi ndërparlamentar, misioni i të cilit do të ishte bashkëpunimi dhe forumi (pse jo edhe koncenzusi) i të gjitha grave parlamentare që të kenë një pjesëmarrje më aktive dhe më shumë kompetenca udhëheqëse krahas me kolegët e tyre mashkuj. Ky 'Komision drejtues i grave' do të ofronte mundësinë që të gjitha gratë parlamentare pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike apo politike të inicojnë dhe të mbrojnë jo vetëm çështjet me interes për to, por edhe për tërë qytetarët e Kosovës.

Fondacion Friedrich Ebert (FES) ka mbështetur idenë që doli nga një diskutim në një tryezë të rrumbullakët me gratë parlamentare në fillim të vitit 2001, kur shumë parlamentarë dhe gra politikane përkrahën idenë e krijimit të një Komisioni drejtues për gra në kuadër të Kuvendit të ri të Kosovës. Përkundër të gjitha përpjekjeve pozitive dhe mbështetjes nga organizatat e ndryshme, idea akoma nuk është realizuar. Si duket, mekanizmat për realizimin e kësaj ideje nuk u gjetën apo ato nuk funksionuan në rrethana të caktuara.



Gratë e fuqishme të komisionit përbëjnë një dukuri të re në parlamentet e shumë vendeve. Meqë çdo ditë e më shumë gra gjenden në parlament, ato me sukses bashkohen përreth një sërë çështjesh. Ekzistojnë përvoja të ndryshme në rajon dhe në Europë e vende të tjera në lidhje ekzistimin e trupave të tilla në kuadër të parlamenteve, disa prej tyre duke funksionuar si komisione të mirëfillta parlamentare (si në Gjermani), disa të tjera si grupe nënparlamentare apo edhe ndërparlamentare që do ti përgjigjej më mirë rastit në Kosovë.

Idea sërish del në sipërfaqe, FES-i është gati të inicojë dhe të mbështesë debatin mbi format e mundshme dhe mekanizmat e funksionimit të një grupi të tillë për të rritur pjesëmarrjen demokratike të grave politikane në një debat mbi çështjet madhore për Kosovën.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjuhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikant Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë) në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Deputetët e Kuvendit, duke dhënë betimin në fillim të mandatit të dytë të Kuvendit të Kosovës.

<http://www.kuvendikosoves.org>
<http://www.skupstinakosova.org>
<http://www.assemblyofkosovo.org>

Fotografit e këtij buletini: Kuvendi Kosovës faqet 1 dhe 4, OSBE-ja faqet 2,5,6,12,15,16,18,19,20, BE-ja faqet 3 dhe 13, Koha ditore faqja 9, ditorja Express faqja 10, dhe UNMIK-u faqja 11

ASI
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
 Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
 kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t